

# SFIDAT NGA ZBATIM I MËSIMIT NË DISTANCË NË KOHË TË KOVID - 19, NË ARSIMIN E MESËM





# PËRMBAJTJA

HYRJE

1

METODOLOGJIA

2

**PJESA 1** - PËRDORIMI I MJETEVE DIGJITALE  
PARA KRIZËS

3

**PJESA 2** - SI U ZHVILLUA MËSIMI ONLINE?

6

**PJESA 3** - KOMPETENCAT E MËSIMDHËNËSVE

11

**PJESA 4** - KUSHTET TEKNIKE DHE  
DIGJITALE PËR REALIZIMIN E


17

**PJESA 5** - ROLI I INSTITUCIONEVE,  
MASH DHE SHKOLLAT E MESME  
NË REALIZIMIN E MËSIMIT NË DISTANCË

23

**PJESA 6** - REKOMANDIME PËR AVANCIMIN  
E MËSIMIT NË DISTANCË, POR EDHE PËR  
DIGJITALIZIMIN E PROCESIT ARSIMOR  
TË RREGULLT

28



Kriza, e shkaktuar nga virusi KOVID-19, në mënyrë të pashmangshme ka pasur një ndikim në arsimin e mesëm në Maqedoninë e Veriut, veçanërisht në mënyrën e zhvillimit të mësimin. Në vend të mësimin të rregullt, pothuajse i gjithë tremujori i fundit i vitit shkollor u zhvillua me të ashtuquajturën, mësim në distancë.

Por, sa ky model i arsimit është në linjë me të drejtën për arsim të përkufizuar në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara<sup>1</sup>, me parimet e arsimit cilësor dhe inkluziv dhe me dispozitën ligjore për arsim të mesëm falas, për çdo nxënës?

E drejta për arsimim është e drejtë universale e çdo fëmije, kështu që, si në procesin e rregullt arsimor ashtu edhe në të gjitha modelet e tjera të mësimdhënies, duhet të merret parasysh dhe të garantohet që modeli i ri do të përshtatet në mënyrë të barabartë dhe do të jetë i arritshëm për çdo nxënës. Kjo do të thotë që gjatë krijimit të tij, duhet të merren parasysh kushtet, teknike dhe sociale, mundësitë dhe nevojat e nxënësit, si dhe rreziku nga thellimi i hendekut shoqëror midis nxënësve, dhe veçanërisht duhet kushtuar vëmendje situatës në të cilën gjenden fëmijët dhe të rinjtë nga kategori të rrezikuara sociale dhe me më pak mundësi.

Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet se, në përputhje me Ligjin për arsimin e mesëm, çdo nxënës duhet t'i sigurohet arsim i mesëm falas, në shkollat e mesme<sup>2</sup>. Kjo do të thotë që gjatë ndryshimit të modelit arsimor ose vendosjes së modelit të ri, siç është modeli i mësimin në distancë, duhet të garantohet parimi i arsimit falas, përkatësisht se nxënësit nuk do t'i nënshtrohen implikimeve financiare.

Si organizata që kanë punuar së bashku për 5 vjet, mbi tema në lidhje me arsimin e mesëm, pjesëmarrjen e nxënësve dhe digjitalizimin, situata me mësimin në distancë ka ngjallur interes të veçantë për sa i përket suksesit, efektivitetit dhe sfidave në zbatimin e tij.

Duke marrë parasysh situatën me KOVID-19 dhe skenarët e mundshëm për vazhdimin e krizës, me këtë hulumtim duam të kontribuojmë kryesisht në përmirësimin e përdorimit të mjeteve digjitale si plotësim i procesit të rregullt arsimor dhe përmirësimin të praktikave të mësimin në distancë në kushte të pamundësisë për mbajtjen e mësimin të rregullt.

Në mënyrë konsekuente, objektivat e hulumtimit janë:

- 1 Të identifikohen mënyrat dhe frekuenca e mësimin në distancë
- 2 Të identifikohen praktikat më të mira dhe sfidat në zbatimin e mësimin në distancë
- 3 Të gjenerohen rekomandimet për përmirësimin e mësimin në distancë në mësimin e rregullt.

<sup>1</sup> Neni 26, [https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR\\_Translations/eng.pdf](https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/eng.pdf)

<sup>2</sup> Neni 3, <http://www.sonk.org.mk/documents/Zakon%20za%20sredno%20obrazovanie.pdf>





# PJESA 1

PËRDORIMI I MJETEVE DIGJITALE  
PARA KRIZËS

# SISTEMI ARSIMOR SEKONDAR NUK ISHTE TËRËSISHT I GATSHËM PËR PËRDORIMIN E MJETEVE DIGJITALE NË PROCESIN MËSIMOR

Mjetet digjitale dhe platformat për mësim në distancë ishin përdorur rrallë në mësimin e rregullt para fillimit të krizës me COVID-19. Në 65% të rasteve ato ishin përdorur ose rrallë (një herë në dy javë ose një herë në muaj) ose nuk janë përdorur aspak gjatë mësimin të rregullt. Këto të dhëna, siç do të shihni më poshtë, ndikojnë shumë në cilësinë dhe përdorimin e mjeteve digjitale gjatë mësimin në distancë.

**Para fillimit të krizës, sa shpesh kanë përdorur mjete digjitale mësimdhënësit, në orët mësimore??** (grafikun 1)



Katër herë në javë




Çdo herë



Një herë në dy javë




Një ditë në javë



Dy deri në tre ditë në javë



Një herë në muaj



Aspak



**"Para krizës nuk përdorej asnjë mjet. Tek ne në shkollë kishim një mësimdhënëse që përdorte online teste. "**

- mësimdhënëse 43 vjet

**"Sinqerisht, nuk përdoreshin aspak mjete. U hoqën të gjithë kompjuterët nga klasat ndërsa në mënyrë plotësuere nuk kishte as internet ".**

-mësimdhënëse, 45 vjeç

**"Në çdo klasë të lëndët natyrore, kishim kompjuter dhe projektore dhe me këtë mund të përdornim aplikacione. Por platformat si Google Classroom, kuizet dhe aplikacionet për teste nuk i punonim sa duhet. "**


-mësimdhënëse, 37 vjeç




Si pasojë, sipas nxënësve para se të fillonte kriza si mjet më i përdorur dhe më i zakonshëm në mësimdhënien e rregullt, mësimdhënësit identifikojnë platformat Facebook dhe Viber / WhatsApp në 81% të rasteve. Arsyeja për këtë mund të kërkohej sepse është mënyra më e thjeshtë për t'u lidhur me nxënësit, që megjithatë ka kufizimet e saj. Platformat më komplekse për mësim në distancë si Google Classroom, Edmodo dhe të ngjashme ishin shumë rrallë të përfaqësuar, në vetëm 15% të rasteve, ndërsa komunikimi me postë elektronike ishte mjeti më pak i përdorur me vetëm 3%. Prandaj, mund të vërehet gjithashtu se, për fat të keq, ekziston një nivel i ulët i shkrim-leximit digjital, si mes arsimtarëve ashtu edhe nxënësve, sepse rrjetet e mesipërme sociale, si Facebook, Viber dhe WhatsApp i njohin si mjete mësimore digjitale.

Arsyeja më e zakonshme për përdorimin e këtyre mjeteve është shpërndarja e informacionit në lidhje me mësimdhënien siç janë mësimet, prezantimet dhe testet, por edhe informacione në lidhje me orët si nota, teste dhe mungesa. Vetëm një përqindje shumë e vogël (8%) i referohen mbajtjes së online ligjëratave.

### Mjeti më shpesh i përdorur para fillimit të krizës së virusit COVID-19? (grafikun 2)



### Arsyeja më e zakonshme e përdorimit? (grafikun 3)




### A ju kanë trajnuar mësimdhënësit se si të përdorni mjete digjitale? (grafikun 4)



Është shumë e rëndësishme të theksohet se rreth 51% e nxënësve nuk janë trajnuar kurrë nga mësimdhënësit e tyre se si të përdorin mjete digjitale për qëllime mësimore. Kjo përqindje e lartë nuk është befasuese nëse lidhet me faktin se 64% e mësimdhënësve rrallë përdorin mjete të tilla mësimore (shiko grafikun 1).





# PJESA 2

SI U ZHVILLUA MËSIMI ONLINE?

# MË SHUMË KOHË E SHPENZUAR, A DO TË THOTË REZULTATE MË TË MIRA?

DETYRAT DHE PREZANTIMET DOMINOJNË SI MËNYRË  
E LIGJËRIMIT TË MATERIALIT

Vendimi për të vazhduar mësimin në shkollat e mesme nga distanca, hyri në fuqi dhe iu dërgua shkollave më datë 24.03.2020 gati dy javë pas ndërprerjes fillestare të mësimin të rregullt. I njëjti ka përfshirë 3 mënyra kryesore të zbatimit, nga të cilat më dominues dhe më i shpeshtë prej të cilëve është dërgimi i detyrave dhe prezantimeve me 61% përfaqësim.

Është interesant fakt se platforma EduIno, e promovuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës gjatë krizës, u përmend në vetëm 1% të rasteve, që sugjeron se pothuajse kurrë nuk është përdorur.

Kjo mënyrë e transmetimit të materialit ndikoi drejtpërdrejt mbi mësimin e nxënësve, të cilët thanë se kanë pasur vështirësi për të kuptuar mësimet dhe materialin.

**"Ajo që më shqetëson më shumë është se më kërkohet të zgjidh detyra, të shkruaj ese, etj., për tema me të cilat nuk jam e njoftuar dhe askush nuk është përpjekur të mi shpjegojë ato ose të organizojë orë për atë qëllim."**


-nxënëse, viti i II-të

**"Sfida më e madhe është se ne vetë duhet të "ligjërojmë mësimet."**

- nxënëse, viti i III-të

## Si u zhvillua mësimi gjatë COVID-19?


(më shumë përgjigje ishin të mundshme)  
(grafikun 5)



- Nëpërmjet platformës Eduino (1%)
- Nuk kishim aspak mësim gjatë krizës (1%)
- Me përdorimin e platformave (GogI, Klas rum, edmodo) (26%)
- Me mbajtjen e online ligjëratave (28%)
- Me dërgimin e detyrave dhe prezantimeve (44%)

## Cili mjet për mësim në distancë, përdorej më shpesh?


(grafikun 6)




# NXËNËSIT DHE MËSIMDHËNËSIT KANË SHPENZUAR DUKSHËM MË SHUMË KOHË PËR PUNË GJATË MËSIMIT NË DISTANCË

Përkundër faktit se mësimi në distancë bëhet nga shtëpia, 42% e nxënësve besojnë se u kanë kushtuar më shumë ose shumë më tepër kohë obligimeve shkollore krahasuar me më parë. 33% besojnë se i kanë kushtuar të njëjtën kohë, dhe 25% që i kanë kushtuar më pak ose shumë më pak kohë. Nga ana tjetër, kjo situatë te mësimdhënësit është më ekstreme ku 74% e të anketuarve deklaruan se me një model të tillë mësimor, përgjegjësitë e tyre të punës janë rritur.

**Gjatë kohës së online mësimin a kaloni më tepër kohë në kryerjen e obligimeve shkollore si nxënës (ligjërata, mësimnxënie dhe detyra shtëpie)** (grafikun 7)



**Gjatë krizës, obligimet tuaja si mësimdhënës:** (grafikun 8)



**"Koha që u duhet mësimdhënësve dhe nxënësve të kryejnë obligimet e tyre të punës me këtë lloj mësimdhënies, përfshirë edhe kohën derisa realizohet ora mësimore, por gjithashtu edhe pas orës mësimore është shumë më e gjatë se koha e nevojshme gjatë orës së rregullt në shkollë".**

- mësimdhënës, 56 vjeç. .



# CILËSI ME 3+ OSE 4-?

Shumica e nxënësve mendojnë se mësimi në internet ka qenë i mirë (27,4%) dhe shumë i mirë (28,5%). Një përqindje më e vogël mendon se mësimi ishte i shkëlqyeshëm (16%) por ka edhe nga ata që nuk ishin të kënaqur dhe e vlerësuan atë me notën 2 (17,1%) dhe me notën 1 (11%) që paraqet ¼ e të anketuarit, që gjithashtu është një informacion domethënës.


**NË SHKALLËN PREJ 1 DERI NË 5 (1 MË E ULËT, 5 MË E LARTË) SI DO TË KISHIT VLERËSUAR CILËSINË E ONLINE MËSIMIT TË CILIN E KENI PASUR GJATË KRIZËS?** (Grafiku 9)



Nga ana tjetër, perceptimi i mësimdhënësve është pak më i ndryshëm. Pak më shumë se gjysma e mësimdhënësve (51%) mendojnë se nxënësit nuk janë të kënaqur me këtë mënyrë të mësimdhënies, ku një numër i lartë prej 40% i mësimdhënësve mendojnë se nxënësit janë pjesërisht të kënaqur, 9% mendojnë se nxënësit nuk janë të kënaqur sa duhet, dhe 2% që ata nuk janë të kënaqur fare.

**Në çfarë mase konsideroni se nxënësit janë të kënaqur me këtë mënyrë të mësimdhënies gjatë krizës?**

(Grafiku 10)




# REZULTATE NË PAJTIM ME QASJEN

Duke pasur parasysh që secili model i arsimit duhet të përshtatet për të gjithë nxënësit, është shqetësuese që vetëm 33% e mësimdhënësve besojnë se modeli i mësimit në distancë i përshtatet pothuajse të gjithë nxënësve (30%) se të gjithë nxënësve (3%).


**Në ç'masë korrespondoni se mësimi në distancë dhe mënyra e transferimit të materialit i përgjigjet stilit të të mësuarit të nxënësve?**

(Grafiku 11)



Por këtu problemi paraqitet gjatë realizimit të këtij lloji të mësimdhënies dhe përshtatshmërisë së materialit për përpunim. Përqindja më e madhe e mësimdhënësve (63%) besojnë se kjo mënyrë e komunikimit dhe mësimdhënies nuk është plotësisht e përshtatshme për materialin mësimor që përpunohet në shkollat e mesme, ku 43% konsiderojnë se kjo mënyrë është pjesërisht e përshtatshme, 28% e konsiderojnë të mjaftueshëm, ndërsa 17% se nuk është mjaftueshëm adekuat. Vetëm 9% e mësimdhënësve besojnë se kjo mënyrë e komunikimit dhe transmetimit të materialit është plotësisht i përshtatshëm për materialin mësimor që përpunohet.

**Në çfarë masë konsideroni se mënyra e këtillë e komunikimit dhe transferimit të materialit është përkatës për materien mësimore që punohet?** (grafikun 12)



Në kuadër të kësaj pjese, mësimdhënësit konsiderojnë se është e nevojshme që programet mësimore të përshtaten dhe ndryshohen, në mënyrë që t'i përgjigjen këtij lloji të mësimdhënies. Sfida më e madhe për transferimin e materies përmes modelit të mësimimit në distancë paraqitet në lëndët profesionale dhe materialet mësimore që kërkojnë aplikim praktik në mësimin dhe përvetësimin e materies.

*"Kishim njoftim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të përshtatim programin për online mësim. Dhe si ta bëjmë këtë? Ne vetëm dimë se si të shkurtojmë një leksion".*

- mësimdhënëse, 41 vjeç

*"Nuk është e mundur të kontrollohet sesa nxënësi në të vërtetë e ka përvetësuar materien, sepse kjo mënyrë e realizimit të mësimimit, është subjekt i manipulimit, ndryshe nga mësimi në klasë, ku mund të monitorohet puna e nxënësit."*

-mësimdhënëse, 56 vjeç.



# PJESA 3


KOMPETENCAT E  
MËSIMDHËNËSVE

# PSE MËSIMDHËNËSIT TANË NUK JANË TË PËRGATITUR PËR PËRDORIMIN E MJETEVE DIGJITALE NË PROCESIN MËSIMOR?


KUSHTET NË SHKOLLA JANË PARAKUSHT PËR DIGJITALIZIMIN E ARSIMIT

Përdorimi i mjeteve digjitale në mësimdhënie kërkon qasje në internet, i disponueshëm si për mësimdhënësit ashtu edhe për nxënësit. Gati gjysma e nxënësve (49%) nuk kanë qasje në internet, sepse shkollat nuk kanë rrjet interneti dhe nuk janë në gjendje të përdorin mjete digjitale. Nga ana tjetër, nga ato shkolla ku ka lidhje interneti, më shumë se gjysma e nxënësve (53%) nuk janë në gjendje ta përdorin atë sepse nuk është i hapur për përdorim falas nga nxënësit.

**Në shkollën Tuaj a ka internet lidhje, që mundëson përdorimin e mjeteve digjitale gjatë orës mësimore** (grafikun 13)



**A është e hapur internet lidhja për përdorim të lirë, për të gjithë nxënësit?** (grafikun 14)



Arsyeja më e madhe (41%) pse rrjetet e internetit në shkolla janë të mbyllura dhe nxënësit nuk kanë qasje është sepse ata kanë frikë se do të keqpërdoret gjatë orëve të mësimit dhe nxënësit do të humbasin përqendrimin nga mësimdhënia. Për më tepër, një përqindje e lartë e nxënësve nuk janë të njoftuar dhe nuk e dinë arsyen pse ndodh kështu (32%). Arsyet e tretë janë problemet teknike dhe sinjalet e dobëta në shkollë që e bëjnë të pamundur përdorimin. Lidhur me këtë dhe si pasojë e problemeve teknike, lidhja është e hapur vetëm për mësimdhënësit që duan ta përdorin atë gjatë mësimit (8%).

**Nëse internet lidhja nuk është e hapur për përdorim, cila është arsyeja për këtë?** (grafikun 15)



# KOMPETENCAT DIGJITALE FITOHEN NËPËRMJET PUNËS PRAKTIKE

Arsyen kryesore për këtë çështje mund ta gjejmë në zhvillimin e orëve të rregullta gjatë viteve të kaluara, ku, siç theksohet edhe në të dhënat e mësipërme në këtë analizë, mjetet digjitale nuk janë të përfaqësuara. Kështu që mësimdhënësit nuk kanë përvojë në përdorimin e tyre. Si rezultat, mësimdhënësit dhe nxënësit kanë vështirësi të bëjnë dallimin midis mjeteve mësimore digjitale dhe online mjeteve për komunikim.

## INVESTIMI NË AFTËSITË E MËSIMDHËNËSVE KËRKON VAZHDIMËSI

Asnjë mësimdhënës nuk është trajnuar të përdorë mjete digjitale nga institucionet kompetente në lidhje me atë se si të përdorin mjete digjitale për realizimin e orës mësimore. Trajnimi i vetëm i organizuar nga institucionet kompetente që u përmend është trajnimi i organizuar nga Microsoft për përdorimin e platformës Microsoft Teams. Megjithatë një pjesë e mësimdhënësve ishin të njoftuar me këtë trajnim ose kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në të, shumica e mësimdhënësve nuk ishin aspak të njoftuar se është organizuar një trajnim i këtillë. Është e rëndësishme të theksohet se deri në fund të këtij viti shkollor, kjo platformë nuk është instaluar kurrë në shkollat e mesme, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Një shembull domethënës pozitiv që duhet të theksohet janë dy shkollat e mesme ku menaxhmenti me vetë-iniciativë ka investuar në edukimin e mëtutjeshëm dhe aftësimin e stafit mësimdhënës për të përdorur mjete digjitale gjatë orës mësimore.



**"Unë u përzgjodha të shkoj në trajnim për Microsoft Tims, por nuk e kisha për obligim të mbaj ligjëratë, thjesht ndava materiale"**

- mësimdhënës, 54 vjeç

**"Me iniciativën tonë, si shkollë, organizuam on line trajnim në kohëzgjatje prej gjashtë orë, nga Semos, dhe kjo ndodhi menjëherë sapo filloi gjendja e jashtëzakonshme"**

- mësimdhënëse, 43 vjeç.




Një pjesë e mësimitdhënësve kanë fituar aftësitë e tyre duke përdorur mundësi për arsimim të mëtejshëm përmes arsimit joformal.

**"Arsimi joformal në këtë situatë erdhi shumë në shprehje. Mësimitdhënësit janë ekspertë, por atyre u mungon arsimi joformal për të kryer këtë lloj mësimitdhënie. Ata që kanë pasur arsim joformal janë më të përgatitur, sepse janë mësuar dhe stërvitur për këtë lloj mësimit."**

- Mësimitdhënëse, 34 vjeç.

Kemi rezultate pak më të mira në vlerësimin e aftësive të mësimitdhënësve, nga nxënësit, për përdorimin e mjeteve digjitale. Megjithatë sipas nxënësve, mësimitdhënësit kanë aftësi të konsiderueshme në përdorimin e mjeteve digjitale për të kryer mësimitdhënie online, prapëseprapë, 17% e nxënësve i vlerësuan me notat më të ulëta, 1 (6%) dhe 2 (11%).

**Në shkallën prej 1 deri në 5 (1 minimum, 5 maksimumi), si do t'i vlerësonit aftësitë e mësimitdhënësve që përdorin mjete digjitale për realizimin e online mësimit?** (grafikun 16)



## MËSIMDHNËSIT MUND TË MËSOJNË SHUMË NGA NJËRI - TJETRI

Në shkollat e mesme, në masë të vogël vërehen nisma ku mësimitdhënësit ndajnë përvojat dhe njohuritë e tyre me kolegët në një mënyrë të organizuar. Ky transferim i njohurive zakonisht bëhet përmes komunikimit të ndërsjellë joformal midis mësimitdhënësve. Mësimitdhënësit më të moshuar dhe ata me më pak përvojë në përdorimin e mjeteve digjitale shpesh drejtohen për ndihmë te kolegët e tyre më të rinj dhe më me shumë përvojë.

Në disa shkolla si shembuj pozitive veçohen nismat ku disa mësimdhënës, të cilët kanë njohuri për përdorimin e platformave të tilla si ZOOM dhe Microsoft Teams, kanë edukuar kolegët e tyre për të përdorur këto platforma.



**"Vepronet në mënyrë shumë egoiste dhe shumë rrallë njerëzit i ndajnë njohuritë e tyre"**

*mësimdhënës 54 vjeçar.*




# SI KANË NDIKUAR KËTO GJENDJE MBI MËSIMIN NË DISTANCË?

## KA NXËNËS TË CILËT JANË TË PRIVUAR NGA NDJEKJA E MËSIMIT ONLINE


Megjithëse 85% të larta, u përgjigjën se kanë online orë, megjithatë është e konsiderueshme përqindja e nxënësve (15%) që nuk kanë pasur asnjë online orë, që përsëri mund të ndikojë në vështirësinë e zotërimit të materialit.

Si diçka që ndërlihet, nxënësit e përmendën numrin e lëndëve për të cilat përdoren online ligjëratat dhe platformat interaktive. Në 37% të rasteve, online ligjëratat dhe mjetet digjitale përdoren në

**Gjatë krizës, vallë janë organizuar dhe mbajtur online orë për ndonjë nga lëndët?** (grafikun 17)



**Për sa nga lëndët është përdorur online mësimi dhe platforma digjitale gjatë krizës?** (grafikun 18)



# MËSIMDHËNËSIT BALLAFAQOHEN ME SFIDËN NË MËNYRË CILËSORE DHE PËRKATËSE TË LIGJËROJNË MATERIE MËSIMORE


Pjesë e madhe e mësimitdhënësve, nuk janë në gjendje të përcjellin materialin në mënyrë përkatëse tek nxënësit, përmes modelit të mësimit në distancë. Sfidat më të mëdha për transferimin e materies përmes modelit të mësimit në distancë paraqitet në lëndët profesionale dhe materialet mësimore që kërkojnë aplikim praktik në mësimin dhe përvetësimin e materies. Mësimitdhënësit besojnë se njësi të caktuara mësimore do të duhet të përsëriten në vitin e ardhshëm shkollor, në mënyrë që të kompensojnë atë që nuk është përvetësuar për shkak të mungesës së mundësive dhe mjeteve.

## NUK KA GARANCI SE NXËNËSIT VËRTET KANË MËSUAR

Mësimitdhënësit kanë sfida të vlerësojnë nëse nxënësit me të vërtetë kanë zotëruar materialin të cilin jua ligjërojnë përmes mësimit në distancë., si dhe në mënyrë përkatëse të vlerësojnë dhe të vendosin nota për njohuritë e nxënësve, duke marrë parasysh që ky lloj mësimitdhënie lë shumë hapësirë për manipulim nga nxënësit, gjatë procesit të kontrollit të njohurive.

**"Askush nuk pyet, vetëm shkruajnë detyrat e shtëpisë. Nuk mund të shohim përmes online mësimit nëse nxënësit kanë kuptuar apo jo. Ky mësim nuk mund të përmbushë kriteret"**

*-mësimitdhënëse, 56 vjeç*



# PJESA 4

KUSHTET TEKNIKE DHE  
DIGJITALE PËR REALIZIMIN E  
MËSIMIT

# SI TË REALIZOHET MËSIMI, ME QASJE TË KUFIZUAR NË INTERNET, PAJISJE TË VJETRUAR DHE AFTËSI TË DOBËTA?

Edhe pse sot, më shumë se kurrë, janë të qasshme shumë mjete digjitale që mund të përdoren për realizimin e mësimdhënies, megjithatë mësimdhënësit nga vendi ynë ende përballen me sfida gjatë përdorimit të tyre në periudhën kur mësimi zhvillohej nga distanca.

## MËSIMDHËNËSIT DUHET TË KRIJOJNË VETË KUSHTET PËR REALIZIMIN E MËSIMIT

Sfida më e madhe paraqitet tek mësimdhënësit që nuk kanë pajisje përkatëse, teknologji ose qasje në internet që në kushte shtëpie të realizojnë mësimin. Ky grup përfshin gjithashtu mësimdhënësit që kanë fëmijë që vijnë në mësimin rregullisht dhe nuk kanë pajisje të mjaftueshme elektronike për t'i shërbyer nevojave të të gjithë familjes.

Në disa raste, mësimdhënësit vetë është dashur të investonin në pajisje e cila do tu mundësojë atyre të realizojnë mësimin në kushte shtëpie, pasi shkollat dhe institucionet shpesh nuk kanë investuar në sigurimin e pajisjeve për vetë mësimdhënësit.

Në raste të rralla, në shkolla që mund të theksohen si shembuj pozitivë, mësimdhënësve u është dhënë mundësia të përdorin pajisje laptopë, në mënyrë që ata të mund realizojnë mësimin.

Mungesa e mjeteve digjitale në gjuhët që fliten në Maqedoninë e Veriut, për realizimin e mësimin gjithashtu paraqet një sfidë të madhe për mësimdhënësit, veçanërisht për më të moshuarit që nuk kanë njohuri nga gjuhë të huaja, sepse të gjitha mjetet në dispozicion të tyre janë kryesisht në anglisht. Platforma e vetme në gjuhën maqedonase "EdModo" nuk ishte plotësisht funksionale dhe e disponueshme për t'u përdorur deri në fund të vitit shkollor.

**"Ka mësimdhënës, të cilët janë të vetmit të punësuar në familje. Unë njoh shumë njerëz që morën laptopë me kredi dhe ngecën".**

*-mësimdhënëse, 39 vjeç.*

**"Gjysmës së mësimdhënësve u janë shpërndarë laptopë për të realizuar mësimin nga shtëpia, sipas aftësive dhe nevojave të tyre"**

*-mësimdhënëse 43 vjeç.*

# QASJA DREJT TEKNOLOGJISË DHE PAJISJEVE PARAQET SFIDË EDHE PËR VETË NXËNËSIT

Edhe pse në masë më të madhe (64%) mësimdhënësit konsiderojnë se nxënësit kanë kushte për të ndjekur mësimin në distancë, nuk duhet të neglizhohet dhe një përqindje e lartë e mësimdhënësve (36%) që besojnë se kjo mënyrë e komunikimit dhe transmetimit të materialit nuk është plotësisht e qasshme për nxënësit, nga pikëpamja teknike, përkatësisht 30% e mësimdhënësve konsiderojnë se është pjesërisht i qasshëm, 5% se është pamjaftueshëm i qasshëm dhe 1% që nuk është fare i qasshëm.

**Sa i arritshëm është ky lloj komunikimi dhe transferimi i materialit nga aspekti teknik te nxënësit pra qasja në kompjuter dhe internet?** (grafikun 19)




Mungesa e pajisjeve përkatëse dhe mjeteve ndihmëse teknike për të monitoruar mësimin në distancë është theksuar si një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen mësimdhënësit, pasi kjo ka ndikuar në aktivitetin e nxënësve dhe përfshirjen e nxënësit në mësim. Kjo në veçanti vlen për nxënësit nga familjet e rrezikuara sociale dhe nxënësit e zonave rurale që kanë qasje të kufizuar në teknologji dhe internet, kështu që mësimdhënësit kanë sfidë të madhe të realizojnë komunikimin me ta.

Duke marrë parasysh se arsimi duhet të jetë i qasshëm për të gjithë në mënyrë të barabartë, është shqetësuese që 11% e nxënësve nuk kanë internet lidhje të qëndrueshme dhe 2% nuk kanë pajisje për të ndjekur mësimin.


**A keni një lidhje të qëndrueshme interneti në shtëpi për të ndjekur online mësimin?**

(grafikun 20)



**A posedoni kompjuter, tablet apo telefon për të ndjekur online mësimin?**


(grafikun 21)



Mësimdhënia zakonisht është ndjekur nga telefoni (60%), pastaj kompjuteri (38%) dhe më së paku me pajisje tablet (2%).

Këtu në fakt, shtrohet pyetja se sa telefoni është pajisje e përshtatshme për ndjekjen e mësimit, duke pasur parasysh që ai ka kufizimet e veta, veçanërisht në aspektin e bashkëveprimit me mësimdhënësin dhe kryerjen e detyrave të shtëpisë.

### Nga cila pajisje zakonisht e ndjek online - mësimin? (grafikun 22)



## KUSHTET JO PËRKATËSE REZULTOJNË ME KOMUNIKIM DHE MËSIM JO PËRKATËS

KOMUNIKIMI JO I RREGULLT NDËRMJET MËSIM-DHËNËSVE DHE NXËNËSVE

Edhe pse një numër i lartë prej 33% e mësimdhënësve raportojnë se komunikojnë me nxënësit e tyre çdo ditë, 54% e tyre komunikojnë me nxënësit dy deri në tre herë në javë, dhe 11% e konsiderueshme komunikojnë vetëm një herë në javë.

### Sa shpesh komunikoni me nxënësit të cilët i mësonit gjatë krizës? (grafikun 23)



2% NJË herë në dy javë



11% Një herë në javë 11%




33% Përditë



54% Dy deri në tre herë në javë

Sidoqoftë, nga ata mësimdhënës që komunikojnë çdo ditë me nxënësit, vetëm 6% e tyre komunikojnë me të gjithë nxënësit, ndërsa shumica e mësimdhënësve (65%) komunikojnë çdo ditë me gjysmën ose më shumë nxënës, nga të cilët numër i lartë prej 37% i komunikojnë çdo ditë me pothuajse të gjithë nxënësit dhe 28% e tyre komunikojnë me gjysmën e nxënësve. Një përqindje e konsiderueshme e tyre (24%) komunikojnë çdo ditë vetëm me disa nxënës.

### Me sa nxënës jeni në komunikim të përditshëm? (grafikun 24)



Ata mësimdhënës që deklaruan se nuk kanë komunikim të rregullt me nxënës të caktuar, theksojnë se arsyeja më e zakonshme për këtë është mungesa e kushteve që nxënësit të komunikojnë dhe të ndjekin mësimet. Mungesa e kushteve kryesisht lidhet me sfidat teknike me të cilat përballen nxënësit përkatësisht mungesa e pajisjeve të përshtatshme për komunikim elektronik, si dhe mungesa e aksesit të plotë ose të pamjaftueshëm në internet.

## NDIKIM I KONSIDERUESHËM MBI PLOTËSIMIN E NXËNËSVE

Megjithëse shumica e nxënësve (79%) i kryejnë plotësisht detyrat që u janë caktuar nga mësimdhënësit (23%) ose të paktën mjaftueshëm (56%), megjithatë është e konsiderueshme përqindja e nxënësve (21%) të cilët vetëm pjesërisht (19%) jo mjaftueshëm (1%) dhe aspak (1%) nuk i kryejnë detyrat

### Në ç'masë nxënësit u përgjigjen dhe i përmbushin detyrat që u janë dhënë nga mësimdhënësit? (grafikun 25)



Mësimdhënësit e përfshirë nga ky hulumtim shprehen se arsyet për këtë janë mungesa e kushteve të shtëpisë për të ndjekur orët mësimore, përkatësisht mungesa e pajisjeve teknike të përshtatshme për përdorim.




# MËSIMI PERCEPTOHET SI JO MJAFTUESHËM EFEKTIV NGA ANA E NXËNËSVE

Pothuajse 69% e nxënësve nuk mendojnë se mësimi online ndihmon mjaftueshëm në procesin e mësimin dhe përvetësimin të materies, dhe pak më shumë se 68% se ajo nuk korrespondon plotësisht me lëndët dhe profesionin që ata mësojnë.

Online mësimi ndihmon gjatë procesit të mësimin dhe përvetësimin të materies?

Online mësimi u përshtatet lëndëve de structures, të cilat i mësoj?



(grafikun 26)



# PJESA 5

ROLI I INSTITUCIONEVE,  
MASH DHE SHKOLLAT E  
MESME NË REALIZIMIN E  
MËSIMIT NË DISTANCË

# SI TË ARRIHET MËSIM CILËSOR ME KOORDINIM TË VOGËL DHE UNIFIKIM TË DOBËT?

Qasja kryesore e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, siç shihet nga hulumtimi, është që shkollave u jepet liri të zgjedhin mënyrën më të përshtatshme për të kryer mësimin në distancë. Kjo qasje nuk është problem në vetvete, por në kushte kur pothuajse i gjithë stafi mësimor nuk ka marrë trajnime për të përdorur mjete të tilla as nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, as nga vetë shkollat, ndërsa iniciativa dhe përdorimi i mjeteve të tilla nga mësimdhënësit është i ulët, pasojat mund të jetë të konsiderueshme.

Të gjithë mësimdhënësit vunë në dukje se në shkollat e tyre nuk ka qasje të unifikuar për zbatimin e mësimdhënies, përkatësisht se mësimdhënësit kanë lirinë të organizojnë mësimin vetë, në pajtim me temën e tyre, lëndën dhe nevojat dhe kushtet e nxënësve. Gjatë mbajtjes së orëve mësimore, mësimdhënësit u udhëzuan gjithashtu nga rekomandimet e dhëna nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Në kushte të tilla, theksohet roli i shkollave dhe veçanërisht i drejtorëve në mënyrë që të organizojnë dhe sistemojnë mësimin. Kështu, përveç në dy shkolla, në asnjë prej shkollave të përfshira me hulumtimin nuk është kryer sipas një programi të veçantë për online mësimdhënie që përfshin online klasa, dërgimin e mësimëve dhe detyrave. Kjo situatë ndonjëherë rezulton me mbingarkesë të nxënësve dhe jo konsistencë në qasje.

***Nuk ka orar mësimi, dhe secili mësimdhënës ju dërgon fëmijëve sipas dinamikës së tij. Nuk ka sistem të harmonizuar. Mund të ndodhë të hënën që askush nuk u dërgon asgjë, dhe të martën të gjithë 15 profesorët ju dërgojnë detyra.***

*- mësimdhënëse, 36 vjeç*

***"Fëmijët dinin të na thoshin...Mësimdhënëse, ne nuk jemi robotë "***

*- mësimdhënëse, 42 vjeç.*

***"E vetmja gjë që bëhet është të mbingarkoni nxënësit me detyra të shtëpisë në një mënyrë krejtësisht të çorganizuar. "***

*- nxënës, viti i II-të.*

# REALIZIM PA VLERËSIM

Nga intervistat e thella të kryera, në asnjë prej shkollave, në periudhën e mësimit në distancë, nuk është realizuar vlerësim i planifikuar dhe thelbësor. Mësimdhënësit kryesisht vlerësuan situatën gjatë këshillave të mësimdhënësve dhe në disa vende edhe përmes online mbledhjeve prindërore.

Si praktika në disa shkolla u përmendën edhe anketat me nxënës dhe prindër, që të shihet kënaqësia e nxënësve gjatë procesit mësimor.

Në disa shkolla, si praktikë për monitorimin e procesit mësimor të këtij lloji, janë përdorur raporte të rregullta, të cilat janë dorëzuar nga mësimdhënësit për punën e bërë në periudhën e kaluar, në shërbimet e shkollës, si dhe për mbajtja e dosjeve elektronike.

**"Mësimdhënësit, përveç në lëndët e tyre mësimore, nuk i dinë rezultatet dhe kushtet që kanë rezultuar nga ky lloj i mësimdhënies sepse nuk është bërë asnjë vlerësim".**

- mësimdhënëse, 31 vjeç.

**"Unë mendoj se pas përfundimit të krizës nuk duhet të harrojmë sfidat, duhet të mësojmë nga kjo dhe të bëjmë një strategji të qartë që ky lloj mësimdhënie të promovohet për t'u përballur me gjendjet e jashtëzakonshme edhe në të ardhmen, edhe nëse mësimi është i rregullt".**

- mësimdhënëse, 56 vjeç.

## NËSE GJYKOHET PESHKU NGA AFTËSITË E TIJ TË NGJITË NJË PEMË, NUK DO TË DIJË

Konservatorizmi në qasjen dhe mësimin bazuar në informacione dhe fakte, është ajo që karakterizon sistemin tonë arsimor. Në këto kushte, nxënësit që kanë vështirësi me këtë lloj mësimi nuk vinë në shprehje. Sidoqoftë, kriza dhe online mësimi kanë treguar trendet e mëposhtme.

Nxënësit që ishin më pasivë, më të qetë dhe kishin vështirësi për të mësuar gjatë orëve të rregullta ishin ndër më aktivët dhe më të mirët gjatë mësimit në distancë. Sipas mësimdhënësve, arsyeja për këtë është fleksibiliteti i ofruar nga ky lloj mësimdhënie, i cili stimulon kuriozitetin dhe hulumtimin e lëndës dhe rrit performancën e nxënësve sepse ata mund të organizojnë vetë procesin e mësimit dhe përmbushjen e detyrimeve shkollërore.

Sidoqoftë, ka edhe studentë që demonstrojnë mosinteresi të plotë në mësimdhënie pasi të kenë kaluar këtë model të të mësuarit në distancë. Shpesh arsye për këtë është mungesa e kushteve të shtëpisë për të ndjekur orët, mungesa e pajisjeve të duhura ose vështirësi në të nxënë. Kur bëhet fjalë për këta nxënës, mësimdhënësit kanë një sfidë të madhe për të gjetur arsyet e mos interesimit të tyre, por ata gjithashtu kanë sfidë gjatë vlerësimit të njohurive dhe përcaktimit të notave për ata nxënës.

**"Disa nxënës më befaskan. Punuan shumë më tepër në këtë mënyrë, sesa në orë klasike. Me siguri këtyre fëmijëve vetë kontakti me mësimitdhënësit ju ofron pasiguri. Së dyti, ata nuk përballen me nxënës të tjerë dhe gjithnjë e më tepër janë individualistë. Ne duam t'i uniformojmë fëmijët. Nëse një peshk gjykohet nga aftësitë e tij, të ngjitet në një pemë, nuk do të dijë"**

- mësimitdhënëse, 41 vjeç

## NOTAT JOREALE SI SFIDË E MADHE

Mësimitdhënësit e përfshirë në intervistat e thella deklaruan se nuk ka sistem vlerësimi të përshtatur me modelin e mësimit në distancë, por që kriteret dhe metodat përdoren si në mësimitdhënien e rregullt.

Me vendosjen e modelit të mësimit në distancë, mësimitdhënësit gjatë vendosjes së notave janë udhëhequr kryesisht nga rekomandimet dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për të marrë parasysh notat që kishin nxënësit deri në ndërprerjen e klasave të rregullta në shkollë, kur përcaktohet nota për e fundvitit, por përveç kësaj për t'u dhënë nxënësve mundësinë për të korigjuar notat

duke marrë pjesë në mësimit, duke bërë ushtrime, detyra dhe në disa raste nëpërmjet online pyetjes dhe testimëve. Megjithatë, mësimitdhënësit u lanë vetë të kryejnë procesin e vlerësimit të njohurive të nxënësve, duke pasur mirëkuptim për gjendjet dhe kushtet në të cilat ndodhen nxënësit, gjatë ndjekjes së mësimit në distancë. Sipas tyre, kriteret vendosjen e notave është dashur dukshëm të ulen gjatë mësimit në distancë.


Përqindja më e madhe e mësimitdhënësit (63%) besojnë se këto mjete nuk janë plotësisht përkatëse për këtë proces, ku një përqindje e lartë prej 39% i mësimitdhënësvë besojnë se vetëm pjesërisht mund të vlerësohet dhe përcaktohet shkalla e zotërimit të materialit, 21% e mësimitdhënësvë besojnë se nuk janë mjaftueshëm adekuate, dhe 3% se nuk janë aspak të përkatëse.

**"Sipas mendimit tim, ne nuk ishim më realistë në vendosjen e notave dhe mendoj se nxënësit u shpërblyen te të gjithë kolegët edhe në shkollat e tjera."**

- mësimitdhënëse, 37 vjeç.

Nga ana tjetër, një përqindje e lartë e mësimitdhënësvë (31%) konsiderojnë se mjetet janë mjaftueshëm përkatëse, ndërsa 6% se ato janë plotësisht të përkatëse për zhvillimin e procesit të vlerësimit dhe përcaktimin e shkallës së zotërimit të materialit nga nxënësit.

**Sa mund të monitorohet dhe vlerësohet procesi i mësimi të nxënësve, si dhe të përcaktohet shkalla e përvetësimit të materialit, me këto mjete? (grafikun 27)**




Nga mësimdhënësit u theksua se pikërisht çështja e vlerësimit të njohurive dhe notimit të nxënësve është një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen.


Ajo që përmendet është se, me rëndësi të madhe është të sigurohet që secili mësimdhënësi të ketë mjetet dhe pajisjet e duhura për të zbatuar në mënyrë efektive një program mësimor për lëndën e tij, por edhe që nxënësit të kenë kushtet e përshtatshme dhe mjetet teknike për ndjekjen e papenguar të mësimdhënies.

**"Nuk është e mundur të kontrollohet sesa nxënësi në të vërtetë e ka përvetësuar materien, sepse kjo mënyrë e realizimit të mësimi, është subjekt i manipulimit, ndryshe nga mësimi në klasë, ku mund të monitorohet puna e nxënësit".**  
- mësimdhënësi, 56 vjeç.

**A mundëson online mësimdhënia, hapësirë reale për vlerësim?? (grafikun 28)**



Sipas nxënësve, online mësimi në pjesën më të madhe (47%) ose pjesërisht konsiderojnë se siguron hapësirë për notim real. Në këtë drejtim, 33% besojnë se nuk siguron hapësirë, dhe 20% se siguron hapësirë për notim real.



# PJESA 6

REKOMANDIME PËR AVANCIMIN  
E MËSIMIT NË DISTANCË, POR  
EDHE PËR DIGJITALIZIMIN E  
PROCESIT ARSIMOR TË  
RREGULLT

# PËR AVANCIMIN E MËSIMIT NË DISTANCË

1

Kryerja e vlerësimit të detajuar dhe të strukturuar të procesit të mësimit në distancë në periudhën e kaluar, me qëllim të përmirësimit të mësimit në distancë në të ardhmen.

2

Krijimi i strategjisë së qartë me udhëzime të qarta për zbatimin e mësimdhënies dhe procesin e notimit të njohurive të nxënësve, përmes modelit të mësimit në distancë, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet e tjera përgjegjëse për arsimin formal në vend.

3

Përcaktimi dhe rregullimi i rrjedhës së procesit mësimor dhe mbajtja e orëve mësimore.

4

Përshtatja e programeve mësimore që do të korrespondojnë me këtë model të mësimdhënies dhe do të garantojnë një proces efektiv arsimor, për secilën lëndë në veçanti, duke marrë parasysh njësitë tematike që përpunohen, situatën e mësimdhënësve dhe nxënësve, si dhe mundësitë teknike për zbatimin e atyre materialeve mësimore.

5

Sigurimi i pajisjeve dhe teknologjisë së duhur për mësimdhënësit dhe nxënësit (laptopë), në mënyrë që mësimi i këtij lloji të mund të kryhet pa probleme dhe të plotësojë nevojat e materieve mësimore.

6

Subvencionimi i blerjes së laptopëve, për mësimdhënësit dhe nxënësit, me qëllim plotësimin e nevojave teknike për kryerjen e këtij lloji të mësimdhënies.

7

Vendosja e një platforme kombëtare, të unifikuar, përmes së cilës do të zbatohet mësimi në distancë në të gjitha shkollat e mesme të vendit ose vendosja e një platforme ekzistuese siç është platforma "Zëri im". Platforma duhet të ofrojë mundësinë për zhvillimin e mësimit online me nxënësit, të ofrojë mundësi për të ndarë materiale dhe detyra me njëri-tjetrin, të ofrojë një sistem efikas për kryerjen e testimit të nxënësve, si dhe fitbek sistem nga nxënësit dhe mësimdhënësit dhe për monitorimin e procesit të kryerjes së online mësimit.



8

Lidhja e platformës kombëtare për mësim në distancë me e-ditarin ekzistues, me qëllim zvogëlim të obligimeve administrative të mësimdhënësve.

9

Sigurimi i programeve të përshtatshme, që përdoren për lëndë të caktuara dhe njësi mësimore, për mësimdhënësit dhe nxënësit.

10


Krijimi i mundësive për aftësimin plotësues të mësimdhënësit, me qëllim të fitimit të kompetencave digjitale, përkatësisht aftësi për përdorimin e mjeteve digjitale për mësimdhënie, si dhe mundësi për të mësuar gjuhën angleze.

11

Organizimi i orareve online / në distancë për nxënësit, nga administrata e shkollave

12

Shfrytëzimi i muajve të verës për trajnim dhe koordinimin e mësimdhënësve dhe organizimin administrativ të shkollave



# PËR AVANCIMIN E MËSIMIT TË RREGULLT

1

Vendosja e mjeteve digjitale në metodologjinë e punës së mësimeve të shkollave të mesme.

2

Përfshirja e mjeteve digjitale në programet mësimore të shkollave të mesme.

3

Digjitalizimi i procedurave administrative të zbatuara nga mësuesit në punën e tyre.

4

Përmirësimi i informimit dhe aftësive të mësimeve dhe nxënësve për të përdorur mjete digjitale si plotësim i mësimit të rregullt.

5

Sigurimi i kushteve për përdorimin e mjeteve digjitale në mësimdhënie në çdo shkollë, në drejtim të qasjes në internet dhe pajisje elektronike për mësuesit dhe nxënësit.

6

Vendosja e trajnimit të detyrueshëm për aftësi digjitale për çdo mësuesit të sapo punësuar në shkollë